



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:247249

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517212

C.nr.1075/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.D nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,932.25 euro, jashtë seancës, me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit N.D.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.D, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (453.88 euro) x 27% (minusuar 63.18 euro në listën e pagave nga shuma 122.54 euro) = 59.36 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,484.24 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 13.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

III. REFUZHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit N.D mbi shumën prej 1,484.24 euro e deri në shumën prej 1,932.25 euro dhe atë për shumën prej 448.01 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit N.D, t'ia paguajë shumën prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi N.D, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 13.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,932.25 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura. Padiësit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili ka qenë në fuqi deri më datën 06.02.2023, për periudhën kohore nga data 01.01.2021 e deri me datën 31.01.2023 nuk i është llogaritur në pagë diferenca në pagë sipas vendimit të qeverisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 09.02.2024, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë e vetme në këtë çështje kontestimore, ngase sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, në nenin 8 është përcaktuar se “Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”. Në asnjë pikë të vendimit të përshkruar nuk është obliguar Komuna e Rahovecit që të zbatojë këtë vendim. Më tej ka shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e padiësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 41/18 e datës 06.02.2018, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësit; diplomën me numër 1536 e datës 27.03.2018 e lëshuar nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Prishtinës – Qendra në Prishtinë; licencën e mësimdhënësit Nr. 1026258 e lëshuar më datën 10.05.2018 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për padiësin dhe listën e pagave për muajin dhjetor 2020 për padiësin.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se padiësi kishte të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se padiësi posedon licencë të mësimdhënësit. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon padiësit kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe kualifikimit, dhe a është kërkesa e parashkruar.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me numër të protokollit 41/18, e datës 06.02.2018, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësit, gjykata vërtetoi faktin se padiësi N.D kishte të themeluar marrëdhënien e punës te e paditura, me kontratë të përhershme.

Me administrimin e diplomës me numër 1536 e datës 27.03.2018 e lëshuar nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Prishtinës – Qendra në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se padiësi

N.D ka përfunduar programin Matematik – Informatikë më datën 17.03.2017 dhe mori titullin Bachelor i Matematikës – Informatikës.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1026258 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për paditësin N.D, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është licencuar me licencë të mësimdhënësit nga data 10.05.2018.

Me administrimin e listës së pagave për muajin dhjetor 2020 për paditësin, gjykata vërtetoi faktin se në muajin dhjetor të vitit 2020, paditësi N.D në këtë periudhë kishte pagën bazë prej 453.88 euro, ndërsa në emër të kualifikimi i është paguar shuma prej 63.18 euro.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parasheh *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në pjesën tjetër, në shumën prej 448.01 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 në pikën 4 nën-pikën 4 të vendimit përcaktohet se; *“Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*,

në këtë drejtim paditësi në kërkesëpadi ka kërkuar që të kompensohen për 27% të pagës mujore (520.97 euro), ndërsa bazuar në pikën 4 të Vendimit të Qeverisë, paditësi përfitoj ngritje në bazë të pagës bazë dhe jo në bazë të pagës mujore siç pretendon paditësi. Andaj, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadi së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadi së, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësve është dorëzuar më datën 13.11.2023, ndërsa kërkesëpadia e paditësës përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.01.2023. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditësit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 135.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 31.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1075/2023, më datë 28.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.